



Datë: 09.10.2025
Numër Protokolli: 6700/2025

A.nr.1536/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj -Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1536/2025, të datës 05.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, Sh.P kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.1536/2025, të datës 05.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, Sh.P.

A r s y e t i m

Ankuesi, Sh.P (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 05.08.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 05.08.2025 nën shenjën A.nr.1536/2025, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017327, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.08.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa kjo e fundit me datë 05.09.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Inspektorati i Punës, më datë 21.03.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017327, për pozitën e punës “Grupi Administrim të Përgjithshëm, pozita e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin Gjakovës”, numri i kërkuar 3, pozita me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe i është nënshtruar testimit me shkrim si dhe intervistës me gojë, ndërsa sipas Njoftimit të datës 08.07.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së procedurave të rekrutimit, rezulton se kandidatët që ka marrë pikë më së shumti është kandidati A.B me gjithsejtë 87 pikë, kandidatja Z.B, me gjithsejtë 84.6 pikë, dhe kandidati Ç.A, me gjithsejtë 75.4 pikë dhe rezulton të jenë si kandidat të suksesshëm në procedurë.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankesë është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1556/2025 të datës 01.10.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjakovës.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.1556/2025 të datës 01.10.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference RN00017327, për pozitën Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjakovës, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankesë është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1536/2025, të datës 05.08.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1536/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Sh.P;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.